



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel: 355 4 2268 141; Fax: 355 4 2268 142

Nr. 216 Prot

Tiranë, më 20.03.2017

V E N D I M

Nr. 51, datë 20.03.2017

“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Zyrën Arsimore Rajonale Kukës dhe Zyrat Arsimore Has dhe Tropojë, në varësi të saj ”

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil mbikëqyr kryesisht ose me kërkesë të institucioneve, zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë.

Për këtë arsye,

në zbatim të planit vjetor të punës, miratuar me Vendimin nr. 2, datë 13.01.2017, si dhe me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionet që përfshihen në këtë fushë,

VENDOSA:

1. Fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në institucionin e Drejtorisë Arsimore Rajonale të Kukës dhe në Zyrat Arsimore Has dhe Tropojë, në varësi të saj, sipas objektit dhe anekseve që përmban Programi i Mbikëqyrjes, i cili është pjesë e këtij vendimi.
2. Ngritjen e grupit të punës, me këtë përbërje:

- **Ilia Kukumi** **Drejtor i Inspektimit dhe Hetimit Administrativ**
- **Zamira Mujali** **Inspektore**
(Përgjegjës grupi)
- **Atalvin Niço** **Inspektor**
(Anëtar)

3. Mbikëqyrja do të fillojë me paraqitjen e grupit të punës në Drejtorinë Arsimore Kukës në datë **23.03.2017** dhe do të vijojë me procesin e grumbullimit të të dhënave.

Në lidhje me mbikëqyrjen në Zyrat Arsimore Has dhe Tropojë, procesi do të vijojë në varësi të paraqitjes së dokumentacionit nga ana e këtyre të fundit, pranë DAR Kukës.

Nëse gjatë fazës së përpunimit të të dhënave lind nevoja për të përsëritur vizitën në subjekt, ky proces do të realizohet me kërkesën e grupit të punës.

4. Me përfundimin e këqyrjes së akteve, grumbullimit të dokumentacionit dhe të dhënave në subjekt, grupi i punës, nën drejtimin e Drejtorit të Inspektimit dhe Hetimit, do të vijojë procesin me përpunimin e të dhënave dhe përgatitjen e projektraportit të mbikëqyrjes. Projektraporti do të përfundojë në datën **28.04.2017** dhe pasi t'i paraqitet Komisionerit për miratim, më tej, do t'i dërgohet institucionit të mbikëqyrur për t'u njohur me gjetjet, duke i lënë 15 ditë kohë për të përgatitur observacionet, deri në datën **13.05.2017**.
5. Pas përfundimit të afatit për njohjen e subjektit të mbikëqyrur me raportin paraprak, grupi i punës do të hartojë raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, ku do të përfshihet edhe analiza e observacioneve, e në datën **25.05.2017**, do t'i paraqitet Komisionerit për miratim.
6. Nëse gjatë procesit të mbikëqyrjes nuk arrihet të respektohen afatet e vendosura, drejtuesi i grupit të punës duhet të kërkojë zgjatje afati tek Komisioneri, duke argumentuar edhe arsyet për mospërfundimin e procesit në afat.
7. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes që të marrë masat për realizimin e procesit, duke filluar me njoftimin e subjektit që do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes në përputhje me nenin 87, të ligjit nr.44/2015 "*Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*" dhe të akteve që janë pjesë e këtij vendimi.
8. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse që të sigurojë mbështetjen e grupit të punës me logjistikë, për vijimin normal të procesit, në përputhje me programin e miratuar.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA